



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Kabineti i Ministres - Kabinet Ministra - Cabinet of the Minister

Ref. Nr.01/54
Prishtinë: 05.11.2021

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 10, 11, dhe 17 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, nr. 7/01 mars 2019), Ligjit Nr.06/L-034 Për Mbrojtjen e Konsumatorit, Ligjin Nr.2004/5 Për Tregtinë me Naftë dhe Derivate të Naftës në Kosovë dhe Ligjin Nr.03/L-181 Për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, Ligjit Nr.06/L-041 Për Kërkesat Teknike për Produkte dhe Vlerësim të Konformitetit dhe nenit 8 Paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 i Rregullores nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, merr këtë:

V E N D I M
Për Vajrat Motorike

Neni 1
Qëllimi

Me këtë Vendim përcaktohen vlerat kufizuese të vajit motorik që përdoret si lëndë për zvogëlimin e fërkimeve, për bartjen e fuqisë, bërjen e nxehtësisë, ftohjen dhe mbrojtjen nga korrodimi.

Neni 2
Llojet e Vajrave

1. Vendimi zbatohet për vajrat të cilat përdoren për lyerjen e motorëve, të cilat në bazë të vetive të caktuara kimike-fizike dhe në përputhje me destinimin, klasifikohen në këto kategori:

- 1.1 Vaj industrial;
- 1.2 Vaj motorik;
- 1.3 Vaji për dhëmbëzoret e automjeteve transportuese;

- 1.4 Lubrifikuesit për lyerje;
- 1.5 Vajrat për përdorime të veçanta.

Neni 3 **Vajrat Industriale**

Vaji industrial karakterizohet me klasifikimin e viskozitetit sipas standardit ISO 3448. Vlerat e karakteristikave për viskozitetin kinematik janë dhënë në temperaturë prej 40°C. Klasat e caktuara njëkohësisht me vlerën e përshtatshme të vlerës së klasës së viskoziteti janë në shtojcën I të këtij Vendimi.

Neni 4 **Vajrat Motorike**

Vaji motorik karakterizohet me klasifikimin sipas viskozitetit të tij. Klasifikim SAE J300 për vajrat motorik është njëra ndër ndarjet me të njohura të vajrave sipas viskozitetit të standardeve amerikane të shoqatave të inxhinierëve të automobilistikës (SAE), sipas metodës ASTM D 445, që paraqitet në shtojcën II të këtij Vendimi.

Neni 5 **Vajrat për dhëmbëzorët**

Vaji për dhëmbëzorët dhe vajra motorik të cilët kanë viskozitet të njëjtë kanë ndarje të ndryshme sipas SAE J306, siç paraqitet në shtojcën III të këtij Vendimi.

Neni 6 **Lubrifikuesit për Lyerje**

Më së shpeshti përdoret klasifikimi qëndrueshmëria e lubrifikuesve për lyerje që bazohet në institutin nacional amerikan për lubrifikuesit për lyerje (NLGI), ndërsa standardi internacional i klasifikimit të lubrifikuesve për lyerje është ISO 6743-9 është bërë ndarja të lubrifikuesve për lyerje ISO L-X e cila bazohet në kushtet e punës ku përdoren lubrifikuesit dhe bazohen në fortësinë apo butësinë gjegjësisht qëndrueshmërinë e lubrifikuesve. Këtë klasifikim do të paraqesim në tabelën në shtojcën IV të këtij Vendimi.

Neni 7 **Vajrat për Përdorime të Veçanta**

Kërkesat themelore për preparate frenuese, janë të paraqitura në shtojcën V të këtij Vendimi.

Neni 8
Mbikëqyrja e Tregut dhe Testimi i Mostrave

1. Mbikëqyrjen e tregut lidhur me zbatimin e këtij Vendimi e kryen Inspektorati i Tregut i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

2. Në rast të dyshimit në bërberjen e vajit të cekur në nenin 2 të këtij Vendimi, që janë vënë në qarkullim në tregun e Republikës së Kosovës, nuk i përgjigjet vlerave kufizuese të treguesve të përcaktuara me këtë Vendim, Inspektorati i Tregut do të merr mostra dhe të njejtat do të dërgohen për vlerësim të konformitetit te laboratorët e akredituar.

3. Vlerësimi i konformitetit sipas paragrafit 2 e këtij neni do të bëhet nga laboratorit doganor, TVK-të e tjera të akredituar sipas Standardit ISO/IEC 17025 dhe Standardit ISO/IEC 17020 brenda dhe jashtë shtetit.

Neni 9
Shpenzimet e testimit

Shpenzimet e testimit laboratorik të mostrave të përcaktuara në nenin 8 të këtij Vendimi, mbulohen nga Operatori Ekonomik në rast se rezultati i mostrës nuk është konform vlerave të përcaktuara me këtë Vendim dhe jo në përputhje me përbërjen e deklaruar të produktit.

Neni 10

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është shtojca I, II, III, IV dhe V.

Neni 11
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.



Rozeta HAJDARI

Rozeta Hajdari
Ministre e MINT

Shtojca I

Vlerat e karakteristikave për viskozitetin kinematikë sipas ISO 3448 janë dhënë në temperaturë prej 40°C.

Lloji	Viskoziteti kinematikë (mm ² /s) 40°C (minimumi)	Viskoziteti kinematikë (mm ² /s) 40 °C (maximumi)
ISO VG 2	1.98	2.42
ISO VG 3	2.88	3.52
ISO VG 5	4.14	5.06
ISO VG 7	6.12	7.48
ISO VG 10	9.0	11.0
ISO VG 15	13.5	16.5
ISO VG 22	19.8	24.2
ISO VG 32	28.8	35.2
ISO VG 46	41.4	50.6
ISO VG 68	31.2	74.8
ISO VG 100	90.0	110
ISO VG 150	135	165
ISO VG 220	198	242
ISO VG 320	288	352
ISO VG 460	414	506
ISO VG 680	612	748
ISO VG 1000	900	1100
ISO VG 1500	1350	1650

Shtojca II

Vlerat e karakteristikave për viskozitetin kinematikë për vajrat motorike janë dhënë sipas SAE J300 në temperaturë prej 100 °C.

Ndarja e viskozitetit sipas SAE	Viskoziteti me i lartë Dinamik (mPa·s) në temperaturat °C	Kufiri me i lartë i temperaturës së pompimit	Viskoziteti kinematikë [mm ² /s] në 100°C	
			minimale	maximale
0W	3250 / -30	-35	3,8	-
5W	3500 / -25	-30	3,8	-
10W	3500 / -20	-25	4,1	-
15W	3500 / -15	-20	5,6	-
20W	4500 / -10	-15	5,6	-
25W	6000 / -5	-10	9,3	-
20			5,6	9,3
30			9,3	12,5
40			12,5	16,3
50			16,3	21,9
60			21,9	26,1

Me shenja W përshkruhet viskoziteti maksimal të temperaturat e ultë dhe viskoziteti minimal tek temperatura 100°C për vajrat dimëror.

Shtojca III

Vlerat e karakteristikave për viskozitetin kinematikë sipas SAE J306 për vajin dhëmbëzor , janë dhënë në temperaturë prej 100 °C.

Ndarja e viskozitetit sipas SAE	Temperatura maximale e viskoziteti prej 150.00 (10 ⁻³ Pa·s) °C	Viskoziteti kinematikë [mm ² /s] në 100°C	
		minimale	maximale
75W	- 40	4,1	-
80W	- 26	7,0	-
85W	- 12	11,0	-
90	-	13,5	24,0
140	-	24,0	41,0
250	-	41,0	-

Shtojca IV

Vlerat e karakteristikave për viskozitetin kinematikë për lubrifikuesit për lyrje sipas ISO 6743-9.

Shkallëzimi sipas NLGI	Depërtueshmëria e lubrifikuesve për lyrje (0,1mm)
000	445 deri 475
00	400 deri 430
0	355 deri 385
1	310 deri 340
2	265 deri 295
3	220 deri 250
4	175 deri 205
5	130 deri 160
6	85 deri 115

Shtojca V

Vlerat e karakteristikave për preparate frenuese.

	FM VSS 116				ISO 4925	SEA J 1703
	DOT 3	DOT 4	DOT 5.1	DOT 5		
Pika e vlimit të rrjedhjeve të thata, °C, min.	> 205	> 205	> 205	> 205	> 205	> 205
Pika e vlimit të rrjedhjeve të thata, °C, min.	> 140	> 155	> 185	> 180	> 140	> 140
Viskoziteti maximal në -40 °C, mm ² /s	< 1500	< 1800	< 820	< 1900	< 1500	< 1800
Viskoziteti maximal në 100 °C, mm ² /s	> 1,5	> 1,5	> 2,1	> 1,5	> 1,5	> 1,5